



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 24.5.2022, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajraliu, Eman Rrahmani, Yllza Hoti, Hajdar Beqa, Albana Bytyçi, Halil Thaçi, Adem Hoxha, Rashit Qalaj dhe Mirlinda Tishukaj-Sadiku.

Mungoi: Bekim Arifi.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrës të tjerë: Nagip Krasniqi, Skender Haziri nga KEK, Mirvete Gashi, Arben Selimi dhe Violeta Smajlaj, ZKA, Evetar Zeqiri, OSBE.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.4.2022;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)”. Të ftuar: kryesuesi i Brodit dhe kryeshefi ekzekutiv i KEK-ut;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.4.2022

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.4.2022, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)”.

Hykmete Bajrami, kryetare, theksoi se KMFP, ka vendosur të shqyrtojë raportin e auditimit të performancës “Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)”. Për ti diskutuar të gjeturat e këtij raporti KMFP-ja ka ftuar: Kryesuesin e Bordit dhe Kryeshefin ekzekutiv të KEK-ut. Korporata Energjetike e Kosovës është shoqëri aksionare 100% në pronësi të Republikës së Kosovës. Ajo është organizata me pjesëmarrjen më të madhe në prokurim publik në Kosovë. Gjatë viteve 2018-2020 përmes prokurimit Korporata Energjetike e Kosovës ka lidhur 1,060 kontrata me vlerë të përgjithshme prej 181.5 milionë euro. Aktivitetet e prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës, sikurse në çdo autoritet tjetër kontraktues, duhet të zhvillohen në pajtim me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë. Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar disa aktivitete të prokurimit që Korporata Energjetike e Kosovës kishte zhvilluar gjatë viteve 2018-2020. Auditimi ka përfshirë aktivitetet që nga identifikimi i nevojave, zhvillimi i procedurave të prokurimit deri të menaxhimi i zbatimit të kontratës.

Fushëveprimi i auditimit këtu përfshinë, kontratat e prokurimit të lidhura gjatë viteve 2018-2020 me fokus të veçantë në kontratat e lidhura përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Vlera e përgjithshme e kontratave të lidhura gjatë periudhës 2018-2020 ishte 181.5 milionë euro. Vlera e kontratave të lidhura me këtë procedurë, gjatë këtyre tri viteve, arrin afër 33 milionë euro, që përfaqëson 18% të vlerës totale të kontratave të lidhura nga KEK-u. ZKA-ja ka përzgjedhur gjithsej 108 kontrata në vlerë 7.75 milion euro për t'i audituar. Gjithashtu, edhe kontratat e lidhura me procedurë të hapur janë pjesë e fushëveprimit nga të cilat 55 milionë euro (39 kontrata) janë audituar. Nga to, gjashtë janë kontrata për punë, 33 kontrata të tjera janë kontrata për furnizim.

Aktivitetet e prokurimit janë realizuar kryesisht me negociim të çmimit me ç ‘rast Korporata Energjetike e Kosovës, përveç që nuk ka siguruar transparencë në prokurim, ka paguar më shtrenjtë për mallrat dhe shërbimet e blera. Në specifikime teknike dhe në kritere të përshtatshmërisë teknike dhe profesionale gjatë tenderimit kishte mangësi. Specifikime teknike ishin në disa raste të panevojshme dhe me kritere kufizuese të konkurrencës që ishin pasuar me ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Ankesat kishin marrë kohë për t’u shqyrtuar, e për pasojë Korporata Energjetike e Kosovës kishte lidhur një numër të konsiderueshëm të kontratave të negociuara. Të gjitha këto kontrata kishin rezultuar me çmime më të larta se sa kontratat paraprake apo pasuese, të lidhura me tender të hapur. Kjo përveç që e kishte bërë Korporatën Energjetike të Kosovës joefikase në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit e kishte bërë edhe joekonomike në këto kontrata. Gjithsej shpenzimi shtesë që kishte rezultuar nga prokurimet e negociuara ishte afër 739 mijë euro, 472 mijë euro për njërin tender (shërbimi i transportit) dhe afër 267 mijë euro për tenderin tjetër (sigurimi fizik i objekteve).

Për pasojë ishin lidhur, vit pas viti, kontrata efekti i të cilave ishte i panjohur në drejtim të realizimit të objektivave. Nga gjithsej 377,140 euro që ishin shpenzuar për promovim në media gjatë viteve 2018-2020, KEK-u kishte arritur vetëm 59,113 euro kthim përmes qendrës së trajnimeve profesionale. Pra vetëm 15% të shumës së shpenzuar kishte arritur të shndërronte në të hyra, ndërsa për objektiven tjetër nuk kishte matur efektin. Korporata Energjetike e Kosovës nuk kishte siguruar kombinim optimal të burimeve në dispozicion për të përmbushur objektivat e përcaktuara. Mosgrumbullimi i nevojave për blerje të kushinetave kishte rezultuar numër të madh të aktiviteteve të prokurimit. Gjithsej 34 aktivitete të prokurimit ishin zhvilluar gjatë viteve 2018-2020 vetëm për këto blerje.

Menaxherët e projekteve/kontratave të prokurimit nuk kishin menaxhuar aktivisht kontratat me të cilat ishin ngarkuar. Për shkak të mungesës së iniciativës nga ana e menaxherëve të kontratave Korporata Energjetike e Kosovës nuk kishte siguruar kombinim optimal të burimeve në dispozicion për të përmbushur objektivat e përcaktuara. Shkaqet që kishin çuar në këtë gjendje ishin mospërcjellja aktive e zbatimit të kontratës, mos azhurnimi i datave të dakorduara me kohë dhe mos aplikimi i gjobave për vonesa. Njësitë kërkuese kishin hasur në vështirësi në punë për shkak të vonesave në zbatim të kontratave.

Mungesa e analizave lidhur me përfitimet dhe kostot që rrjedhin nga aktivitetet e prokurimit/kontratave të zbatuara, ka bërë që Korporata Energjetike e Kosovës të vazhdojë me aktivitete të prokurimit që nuk i kishin kontribuar arritjes së objektives.

Përfundimet audituese tregojnë se Korporata Energjetike e Kosovës nuk kishte arritur që fondet publike t'i përdorë në mënyrë ekonomike dhe efikase, kishte mungesë të transparencës si dhe kufizim të konkurrencës. E gjitha kjo ka bërë që disa nga objektivat e përcaktuara përmes prokurimit publik të mos arrihen. Me qëllim të përmirësimit të proceseve të prokurimit, janë dhënë tetë rekomandime për Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin e Korporatës Energjetike të Kosovës. Lista e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin 5 të këtij raporti.

KEK-u është organizata me pjesëmarrjen më të madhe në prokurim publik në Kosovë. Përmes tenderëve publik KEK-u shpenzon dhjetëra miliona euro në vit. Gjatë viteve 2018-2020 përmes prokurimit KEK-u kishte lidhur 1,060 kontrata me vlerë të përgjithshme prej 181.5 milionë euro.

Në vitin 2020, përmes prokurimit publik, KEK-u kishte kontraktuar shpenzime në vlerë prej 36 milionë euro, ndërsa në vitet paraprake (2019 dhe 2018), shpenzimi i kontraktuar ishte 88 milionë euro përkatësisht 56 milionë euro.

Gjatë viteve 2018-2020 vlera e përgjithshme e kontratave që KEK-u kishte lidhur ishte 181.5 milionë euro. Vlera e kontratave të lidhura me procedurë të negociuar, gjatë këtyre tri viteve, arrin afër 33 milionë euro, që përfaqëson 18% të vlerës totale të kontratave të lidhura nga KEK-u, ndërsa pjesa tjetër prej 82% janë kontrata me procedurë të hapur.

ZKA ka audituar afër 35% të vlerës totale të prokurimeve, kontrata të negociuara në vlerë prej 7.75 milion euro dhe 55 milionë euro nga procedurat e hapura.

KEK-u i kishte zhvilluar 34 aktivitete të prokurimit për blerje të kushinetave të llojeve të ndryshme gjatë viteve 2018-2020. Në vitin 2018 i kishte zhvilluar 12 aktivitete pastaj, 12 në vitin 2019 dhe 10 aktivitete në vitin 2020. Dhjetë prej këtyre kontratave i kishte fituar një operator ekonomik i vetëm, ose gati 30% të kontratave.

Zyra e prokurimit e KEK-ut nuk e kishte bërë planifikimin e prokurimit të kushinetave në mënyrë më efikase, megjithëse nevoja për blerje të këtyre kushinetave ishte identifikuar me kohë. KEK-ut iu kanë nevojitur mesatarisht 67 ditë për zhvillimin e secilit nga 34 aktivitetet e prokurimit, nga publikimi i tenderit deri te nënshkrimi i kontratës. Në secilin aktivitet është nevojitur të angazhohet staf për komisione të hapjes së ofertave, të tjerë për komisione të vlerësimit, si dhe për secilën kontratë nga një menaxher i kontratës. Kjo do të thotë se KEK-u nuk ishte efikas në shfrytëzimin e burimeve të veta për shkak se nuk i kishte grumbulluar nevojat për blerje në mënyrë që të zhvillonte më pak aktivitete të prokurimit.

KEK-u kishte lidhur një kontratë në vlerë prej 62,160 euro për blerje të kushinetave. OE i kishte dorëzuar kushinetat në depo të KEK-ut në janar të vitit 2021. Në fund të vitit 2021 gjendja në depo kishte ndryshuar shumë pak. Shumica e këtyre kushinetave ishin ende në depo, ndërsa KEK-u kishte kërkuar garanci për vetëm 12 muaj. Garancia më nuk ishte e vlefshme ndërsa kushinetat ende nuk ishin montuar në pajisje të KEK-ut. Për pasojë çfarëdo defekti eventual që mund të ketë në kushinetat e blera nuk mund të reklamohet tek OE-ja.

ZKA-ja ka kërkuar kartelat e kushinetave edhe për tri kontrata, me vlerë të përgjithshme 64,351 euro, që KEK-u i kishte lidhur gjatë viteve 2019-2020, dhe ka gjetur gjendje të ngjashme sa i përket skadimit të vlefshmërisë së garancisë. Afërsisht gjysma e kushinetave të blera ishin ende në depo: Gjithsej vlera e këtyre kushinetave të mbetura në depo ishte 62,638 euro ose 50% e vlerës së blerjes.

Për promovimin e Korporatës, gjegjësisht për vetëdijesimin e opinionit lidhur me veprimtarinë e saj, KEK-u, kishte lidhur gjithsej 98 kontrata të negociuara me vlerë të përgjithshme 377,140 euro, gjatë viteve 2018-2020. Objektivë shtesë nga ky prokurim ishte edhe promovimi i Qendrës së Trajnimeve Profesionale (QTP) që gjendet në kuadër të KEK-ut, e cila, përmes dhënies së trajnimeve, gjeneron të hyra.

KEK-u kishte negociuar me 46 OE (media audio-vizuele) kontrata, çmimi i të cilave fillonte prej 2,000 euro deri në 8,400 euro në vit.

Kontraktimin e këtij shërbimi me këta OE, menaxhmenti i KEK-ut e kishte parë si zgjidhje për vetëdijesim të opinionit për punën e KEK-ut meqë gjatë monitorimit ditor të mediave kishin vërejtur që pjesa më e madhe e qytetarëve ende nuk ishin mirë të informuar rreth përgjegjësive që kishte KEK-u pas procesit të shthurjes, me theks të veçantë pas privatizimit të Furnizimit dhe Distribucionit të Energjisë Elektrike, përkundër faktit se që nga maji i vitit 2013 afarizmi ekskluziv i KEK-ut është prodhimi.

KEK-u kishte lidhur këso kontrata vit pas viti duke shpenzuar mesatarisht 162 mijë euro në vit, pa e matur asnjëherë efektin e këtyre kontratave. Njësia që e kishte bërë kërkesën për prokurim nuk i kishte specifikuar, para inicimit të aktivitetit të prokurimit, indikatorët e performancës,

Shuma më e lartë që KEK-u kishte paguar për këtë shërbim për OE ishte 8,400 euro në vit. Nga analiza e ueb faqes së KEK-ut ZKA-ja ka gjetur se ky OE i kishte kontribuar qarkullimit (klikimeve) në ueb faqe të KEK-ut me 0.01%. KEK-u nuk na ka ofruar të dhëna se sa janë lexuar artikujt e promovuar të KEK-ut në ueb faqen e këtij OE-je.

Ndërsa OE-ja tjetër që ishte paguar shumë më pak, gjithsej 3,000 euro në vit, i kishte kontribuar qarkullimit në ueb faqe të KEK-ut me 51%. Kjo sipas analizës së qarkullimit (Google analytics) në vitin 2019. As për këtë OE KEK-u nuk ka të dhëna se sa janë lexuar artikujt që janë publikuar në ueb faqen e tij.

Të dhënat e gjeneruara nga Google Analytics për trafikun e referimeve për vitet 2018-2020 tregojnë se më së shumti referime janë bërë përmes njërës prej portaleve të kontraktuara, gjithsej 28,096 referime (vlera e pagesës për tri kontrata ishte 7,200 euro - e renditur si 25-ta për nga përfitimi), derisa përmes mediumit i cili kishte përfituar më së shumti (19,600 euro për tri kontrata), ishin bërë vetëm 16 referime gjatë viteve 2018-2020.

Është e pamundur që nga 377,140 euro që KEK-u ka shpenzuar për tri vite (2018-2020), të ndahen shpenzimet që KEK-u ka realizuar për promovim të QTP-së, megjithatë të hyrat që QTP i ka

realizuar për vitet 2018-2020 ishin vetëm 59,113 euro, që paraqet vetëm 15% të shpenzimit. Për të matur efektin që kanë mundur të kenë kontratat e realizuara për promovimin e qendrës së trajnimeve ne kemi analizuar edhe të hyrat e vitit 2021 (tetor 2021), ku kemi vërejtur se trendi i të hyrave ishte i ngjashëm me vitin 2020.

Puna në prodhim të qymyrit dhe energjisë elektrike në termocentralet dhe mihjet e KEK-ut zhvillohet pa ndërprerje 24 orë në ditë. Prandaj, kontraktimi i shërbimit të transportit të punëtorëve deri në vendin e tyre të punës është parë si domosdoshmëri nga ana e KEK-ut.

Transporti punëtorëve organizohet në tri ndërrime. Linjat e transportit lidhin Prishtinën, Mitrovicën, Vushtrrinë, Podujevën, Drenicën dhe Ferizajn me termocentralet TCA, TCB në Obiliq dhe me Divizionin e Prodhimit të Qymyrit në Bardh i madh, dhe anasjelltas.

Për shërbimet e transportit të punëtorëve të vet, KEK-u kishte nënshkruar tetë kontrata të negociuara njëerën pas tjetrës, përgjatë periudhës tetor 2017 - maj 2019 pas skadimit të kontratës kornizë trevjeçare (2014-2017) e cila ishte bazuar në procedurë të hapur të prokurimit. Vlera e përgjithshme e kontratave të negociuara ishte 2.4 milion euro. Katër kontrata ia kishte dhënë njërit operator ekonomik dhe katër tjerat një operatori tjetër ekonomik.

KEK-u kishte hapur tenderin për shërbime të transportit dhe kësaj radhe e kishte ndarë në tri pjesë e jo sikurse në tenderin e parë vetëm me një operator ekonomik. Mirëpo, e kishte reduktuar vlerën e parashikuar nga 5.2 milion në 3.64 milion (1.56 milion euro më pak) edhe pse numri i kilometrave në total ishte i njëjtë. Çmimi i përlogaritur për km ishte reduktuar nga 1.57 euro në 1.10 euro. KEK-u nuk na ka ofruar asnjë sqarim lidhur me këtë dallim të theksuar në përcaktim të vlerës së parashikuar.

Për këtë shkak edhe ky tender përfundoi me anulim. Ofertat për llotin 1 e tejkalonin substancialisht buxhetin e KEK-ut për këtë prokurim, dhe për llotin 2 ofertuesi i shpallur fitues ishte tërhequr nga gara. Ofertuesit ishin ankuar ndaj vendimit të KEK-ut për anulim të pjesës 1 dhe 2 të tenderit. Kjo ia pamundësoi KEK-ut rishpalljen e tenderit për llotin 1 dhe 2 deri në vendim të OShP-së. Për më tepër KEK-u nuk ia kishte dhënë kontratën as ofertuesit të përgjegjshëm për llotin 3 për shkak të ankesës.

Kontrata e parë e negociuar për tre muaj ishte negociuar me çmim mesatar 1.60 euro (1.51, 1.63 dhe 1.78 euro) për 92,100 km në muaj. Kjo kontratë i kishte kushtuar KEK-ut 442,500 euro. Nëse në vend të këtyre çmimeve të kontraktuara, KEK-u do ta negocionte me OE-në së paku çmimin mesatar të kontratës paraprake (2014-2017) prej 1.23 euro, për tre muaj do të kurseheshin 100,476 euro. Nëse KEK-u do ta ndiqte këtë parim deri në fund, kursimi në total për tetë kontratat e negociuara do të arrinte në 472 mijë euro.

Transporti i punëtorëve të KEK-ut është shërbim i përhershëm në KEK që kontraktohet përmes prokurimit në baza periodike. KEK-u kishte pasur një kontratë trevjeçare që skadonte në dhjetor të vitit 2017. Sipas kësaj kontrate OE-ja duhej të përshkonte 92,100 km rrugë në muaj. Po këtë gjatësi rruge OE-ja duhej ta përshkonte edhe me tri kontrata tjera të njëpasnjëshme, të negociuara me vetëm një OE, deri në korrik të vitit 2018.

Në korrik të vitit 2018 KEK-u e kishte ndryshuar specifikimin teknik, i kishte modifikuar linjat e udhëtimit me çka e kishte rritur rrugën që duhej përshkruar për 1,164 km. Modifikimi i linjave ishte reflektuar me rritje të çmimit të kontratës për transport prej 1,860 euro shtesë në muaj. Me këtë

specifikim teknik të modifikuar, kjo kontratë ishte aplikuar vetëm për tre muaj, aq sa kishte qenë afati i saj. Për kontratën e radhës, KEK-u sërish e kishte kthyer specifikimin teknik të linjave të udhëtimit në gjendjen e mëparshme. Ky specifikim teknik ishte aplikuar për gjashtë muajt në vazhdim.

Kontrata për riparimin e stacionit veprues B=1800 mm prej nënshkrimit të kontratës deri në ekzekutimin e plotë të saj kishin kaluar 22 muaj. Por sipas kontratës, gjegjësisht planit dinamik, kjo punë do të duhej të ishte përfunduar jo më larg se 12 muaj pas nënshkrimit të kontratës. Arsyetimi për zvarritje të kryerjes së punëve ishte se OE-ja kishte probleme me furnizim. Furnizuesi i tij kishte problem me prodhimin e dhëmbëzoreve për reduktorët që duhej montuar në stacionin veprues. Këtë problem OE-ja e kishte raportuar tek MP-ja në shkurt 2020, vetëm një muaj para skadimit të kontratës.

KEK-u e kishte bërë riparimin kapital të turbinës së bllokut B2 me kontratë të negociuar pa publikim në vitin 2019. Një kontratë e tillë ishte arsyetuar me faktin se turbinës nuk mund t'ia bëjë riparimin kapital askush përpos prodhuesit. Kompania që e kishte fituar kontratën i kishte bërë riparimet e nevojshme kosto e të cilave kishte arritur në 3,62 milion euro si dhe punë shtesë 998,676 euro. Turbina ishte funksionalizuar në fund të vitit 2019. Pas dy viteve turbina ishte dëmtuar dhe për këtë ishte nevojitur edhe një intervenim tjetër të cilin e kishte kryer po i njëjti OE. Kjo i kishte kushtuar KEK-ut edhe 248,650 euro ose rreth 5% e shpenzimeve totale të riparimit të turbinës.

Ndryshimi i specifikimit teknik nga pakujdesia kishte sjellë shpenzime shtesë në kontratat për shërbime të transportit të punëtorëve të KEK-ut, ndërsa efekti i ndryshimit është i panjohur. Me këtë ndryshim numri i kilometrave nga 92,100 ishte rritur në 93,264 apo 1,164 km më shumë që kishte sjellë shpenzime shtesë në vlerë prej 25,565 euro, por nuk dihet a kishte sjellë edhe vlerë për punëtorët e KEK-ut që shfrytëzonin transportin, sidomos kur kihet parasysh që numri i tyre kishte rënë vit pas viti, mesatarisht 4%.

ZKA-ja ka rekomanduar Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin e KEK-ut me gjithsej 8 rekomandime, andaj KMFP-ja i rekomandon, përfaqësuesëve të KEK-ut se duhet të përgatitet plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve. Me këtë hapet diskutimi.

Nagip Krasniqi, theksoi se menaxhmenti i KEK-ut së bashku me Bordin e Drejtorëve është i njoftuar me të gjeturat e raportit dhe u zotua se do të merren seriozisht me adresimin e këtyre rekomandimeve, përkundër faktit se disa nga këto rekomandime marrin kohë.

Skender Haziri, theksoi se është kohë e shkurtër prej se kemi marrë mandatin, megjithatë do të merremi seriozisht me adresimin e këtyre të gjeturave. Pajtohemi se ka probleme të shumta të trashëguara.

Albana Bytyqi, pyeti se ZKA-ja për këtë raport ka dhënë 8 rekomandime për Bordin e Drejtorëve dhe për menaxhmentin por vetëm për një rekomandim kemi komentet nga KEK, të paraqitura në raport, pse? Po ashtu përmendi mungesën e koordinimit në mes njërive kërkuese për sa i përket kushinetave dhe mbajta në stoqe për një kohë të gjatë duke ju kaluar afati i garancisë, pse të lejohet kjo nga menaxhmenti i KEK-ut dhe e pyeti kryeshefin e KEK-ut se a ka qenë i punësuar në KEK para sa ta merrte këtë detyrë?

Rashit Qalaj, theksoi se të gjeturat e raportit janë shumë të mëdha, dhe shihet se këtu ka pasur një keqmenaxhim dhe keqpërdorim të parasë publike. Procesi i prokurimit në KEK është i dyshimtë dhe pyeti menaxhmentin se cilat veprime ka ndërmarrë ndaj personave zyrtarë të Drejtorisë së Prokurimit si dhe ndaj njësive kërkuese për këto defekte të lejuara, ndërsa veçoi që raportit i auditimit nxjerrë parregullsi të shumta në procedurat e prokurimit publik.

Hajdar Beqa, paraqiti defektet e paraqitura në këtë raport nga ZKA-ja, dhe pyeti menaxhmentin e KEK-ut, se cilat veprime ka ndërmarrë për adresimin e këtyre të gjeturave? Propozojë që ky raport ti dorëzohet Komisionit hetimor brenda Kuvendit të themeluar ditë më parë, që brenda mundësive ta trajtojë, për arsye se përfshinë periudhën e viteve 2018-2020. Mungesa e menaxhimit të mirëfilltë të kontratave, prokurime njëburimore, procedura të prokurimit me negociim të çmimeve. Pyeti se si është situata tani në KEK, sa i përket respektimit të Ligjit për Prokurimin Publik.

Mirlinda Sadiku-Tishukaj, pyeti se mostrat e marra nga auditorët a përfaqësojnë mostrën reprezentative, siç kërkohet me standardet e auditimit? Po ashtu pyeti se ZKA-ja a i ka në plan të auditimit PVF-të e KEK-ut për sezonin e auditimit 2021/2022? Po ashtu, i propozoi Kreshefit Ekzekutiv të KEK-ut, që nëse ka indikacione se ka ngecje në punën e dikastereve të ndryshme të angazhojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm për të bërë auditime me kërkesa të veçanta! Pse ka ngecje në përgatitjen e termave të referencës për dosje të tenderit, mungesa e eksperiencës së stafit apo mungesa e operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm, apo defekti tek menaxherët e kontratave?

Eman Rrahmani, theksoi se problem në vete paraqesin kontratat e prokurimit publik që bëhen përmes negociimit, e në rastin konkret përmes kësaj procedure në KEK janë rritur edhe vlerat e kontratës, kjo nuk mund të arsyetohet për vetë faktin se nëse ka operatorë ekonomikë të interesuar nuk mund të vazhdohet me negociim të çmimeve apo me kontrata njëburimore, kjo është në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik. Po ashtu, përmendi çështjen e angazhimit të medieve për informim publik, duke kërkuar raport nga KEK-u për KMFP-të se cilat media i ka angazhuar dhe sa ka paguar veç e veç për secilën prej tyre. Po ashtu, pyeti se zyrtarët e Njësies së Auditimit të Brendshëm në KEK, a janë të njëjtit që kanë punuar edhe me parë?

Hajdar Beqa, tha se të gjitha pyetjet e deputetëve po ngritën në bazë të të gjeturave të raportit, si bie fjala tek kontratat me negociim, kontratat njëburimore etj.

Halil Thaçi, pyeti përfaqësuesit e ZKA-së për sa i përket mënyrës së përzgjedhjes së mostrave për auditim për projektin në shumën prej 20 milionë euro, projekt ky i vitit 2020 i cili është dashtë të jetë në mesin e testeve të përfshira në këtë auditim dhe pyeti sa i përket riparimit të Ekskavatorit B-2, i cili qe sa vite është në remont e sipër dhe janë harxhuar miliona euro, mirëpo nuk dihet se kur do të jetë i gatshëm të kthehet në prodhim?

Mirvete Gashi, ndimësauditore e përgjithshme, theksoi se ZKA-ja ka dhënë 8 rekomandime në raport të auditimit për KEK, mirëpo në afatin ligjor ZKA-ja ka pranuar komentet vetëm për një

rekomandim, që pati të bëjë me informimin publik sa i përket detyrave dhe përgjegjësi të KEK-ut.

Mirlinda Sadiku-Tishukaj, theksoi se pasiqë në Parlamentin e Kosovës ka pasur debat parlamentar për çështjen e energjisë ku është diskutuar në seancë si dhe janë themeluar 2 komisione hetimore parlamentare për çështjen e energjisë nuk po e shoh të arsyeshme që ky raport të procedohet në seancë".

Arta Bajraliu, pyeti se pyetësorëve monitorues për monitorim të zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, ku KEK-u nuk i ka plotësuar të njëjtit dhe nuk i ka dorëzuar në KMFP, cilat ishin arsytet për mosplotësim e tyre?

Hykmete Bajrami, kryetare, bëri një rekapitullim për të gjitha të gjeturat e raportit të auditimit dhe për rekomandimet e dala nga ky raport. Ngriti po ashtu çështjen se në raport ZKA-ja ka thënë se nuk kemi vërejtur çështjen e mashtrimit, pyeti se çka konsideron ZKA-ja si mashtrim, nëse këto të gjetura nuk i përkasin kësaj kategorie! Kërkojë që KEK të përgatitë planin e veprimit për adresim të rekomandimeve.

Përfundim

KMPF-ja, vendosi që raporti i auditimit të performancës "Prokurimi në Korporatën Energjetike të Kosovës (2018-2020)". të mos adresohet për në Seancë Plenare. Po ashtu, Zyra Kombëtare e Auditimit përmes Zyrës Ligjore të ZKA-së, të analizojë këtë raport dhe të njoftojë KMFP-në, se a ka brenda këtij raporti elemente korruptive.

4. Të ndryshme

Hykmete Bajrami, kryetare, tha se prapë ka dështuar tenderi për auditim të raporteve financiare të subjekteve politike. Tani vazhdojmë me të njëjtat procedura, ato të presin deri në miratimin e Ligjit të ri për financim të subjekteve politike apo rishikimin e buxhetit të vitit 2022.

Përfundim

KMFP-ja , vendosi që për aktivitetin e prokurimit publik të auditimit të raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2021, të pritët deri në miratimin final të Ligjit për Financim të Subjekteve Politike apo deri me rishikimin e buxhetin për vitin 2022!

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,
Kryetare e Komisionit